



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Prishtina - Municipality of Prishtina

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës,  
mbajtur më 18.9.2024, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina, ( i pavarur), kryesues i Kuvendit, Ermal Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Petrit Reçica (LVV), Arbër Limani (LVV), Feim Osmani (LVV), Violeta Salihu (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Amir Simnica (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Milazim Vitija (LDK), Pëllumb Bajçinovci (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Besë Pestreshi (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Agron Canolli (PDK), Fatmir Dervishi (PDK), Granit Geci (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Gresa Lahu (PDK), Bahri Gashi (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Xhavit Ahmeti (AAK), Gëzim Mehmeti (AKR), Agim Kuleta (LB) dhe Endrit Zabërgja (NISMA).

Munguan: Faton Zeka (LVV), Radie Hoxhaj (LVV), Tiera Kasumi-Berisha (LVV), Edmond Azemi (LVV), Berat Lahu (LVV), Berna Saraçi (LVV), Dasmor Durmishi (LDK), Sami Salihu (LDK), Muhamet Selmani (PDK), Liridon Selmani, (PDK), Arbnora Ajeti (PDK) dhe Sami Boroci (AKR).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama, kryetar, Alban Zogaj, nënkryetar, Valbona Ajeti, drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Bekim Brestovci, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Arbër Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik, Florent Maliqi, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Donjeta Dragusha, drejtoreshë e Drejtorisë së Zhvillimit Rural, Lulzim Fushtica, drejtor i Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, Donika Çetta, drejtoreshë e Drejtorisë së Parqeve, përfaqësues të OSBE-së dhe përfaqësues të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina, kryesues i Kuvendit, i cili tha se për këtë mbledhje është paraparë ky

### Faqe Inga4

## Rend i ditës:

### 1. Propozim-vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2025.

Arsyetimin për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2025, para të pranishmëve në pika të shkurtra e paraqiti Valbona Makolli, drejtoare.

Gëzim Sveçla, fillimisht tha se është e pa pranueshme që miratimi i një dokumenti kaq të rëndësishëm po ndodhë përmes një seance të jashtëzakonshme, një praktikë kjo tashmë tradicionale e këtij ekzekutivi, ku gjërat e rëndomta cilësohen e shndërrohen në të jashtëzakonshme, e në fakt sot e jashtëzakonshme është vetëm tendenca e kësaj qeverisje për ta kontrabanduar këtë projektbuxhet. Ky projektbuxhet është dëshmia më e qartë e një dështimi që po i kushton qytetit tonë. Nëse e analizojmë përmbajtjen e këtij buxheti, shohim se ai bie në kundërshtim me premtimet elektorale të kryetarit Rama dhe nuk përfaqëson interesat dhe prioritetet e qytetit karshi nevojave dhe kërkesave të qytetarëve. Kjo dëshmohet më së miri me vetë faktin se kemi një rënie të investimeve kapitale në sektorët kyç të qytetit, siç janë shëndetësia, sporti, kultura, bujqësia etj.

Ky buxhet nuk i përfaqëson aspiratat dhe premtimet e bëra qytetarëve të Prishtinës, por është një buxhet që reflekton vetëm interesat e ngushta të atyre që e mbajnë pushtetin për vete e jo për qytetarët, pra është një dështim, sepse nuk përfaqëson nevojat e qytetarëve.

Jeta Rafuna tha se ky buxhet është themeli, mbi të cilin ndërtohen shumë projekte të reja në sfera të ndryshme. Pra, është një buxhet që është i mbështetur në politikat globale të zhvillimit të qëndrueshëm, me fokus te qytetari, për të krijuar kushtet sa më të mira për një jetë të mirë dhe të shëndetshme. Qëllimi i kryetarit Rama dhe ekipit të tij për vitin 2025, është vazhdimi i transformimit të Prishtinës në një qytet modern, të qasshëm dhe të qëndrueshëm.

Në këtë buxhet është paraparë rritje e investimeve në infrastrukturën publike, në arsim, në shëndetësi, në mjedis, në teknologji etj., andaj në emër të grupit të asamblastëve të LDK-së ju ftoj, pavarësisht përkatësive partiake, ta mbështesim të gjithë këtë buxhet dhe të gjitha projektet që ai i përfshinë.

Leutrim Retkoceri, fillimisht ngriti shqetësim, duke ceku se në këtë situatë është e paçartë arsyeja që buxheti i vitit 2025 për Kryeqytetin, po trajtohet përmes një mbledhjeje të jashtëzakonshme dhe jo përmes mbledhjes së rregullt. Ky buxheti sot i ardhur si dokument, është dashur që projekti të dorëzohej më 1 shtator, e që ne të kishim mundësinë të diskutojmë edhe me qytetarë, sepse këtë formë e parasheh edhe ligji. Këtë buxhet ne si Grup parlamentar, do ta kishim përkrahur nëse do të kishte planifikime të bazuara në nevojat elementare të qytetarëve, mirëpo nuk ka ndodhur ashtu. Në këtë seancë të jashtëzakonshme ku buxheti i kryeqytetit tenton të kalohet, nga ana e grupit tonë as nuk e meritoni besimin, e as mundësinë që të ndërtoni një buxhet shkel e shko.

Kjo seancë e jashtëzakonshme duhet të përfundojë, sepse nuk ka asgjë të zakonshme. Për këtë dokument ne mendojmë se nuk i përmbushi as nevojat e qytetarëve dhe nuk duhet ta gëzojnë as besimin që të kalojnë në formën e tillë.

**Gëzim Mehmeti** tha se ka pasur një reagim të organizatës IMPO, nga monitorimi i rregullt i Komunës së Prishtinës, nuk ka identifikuar që Kuvendi i Komunës të ketë mbajtur dëgjime buxhetore nga qytetarët. Ka pasur apo s'ka pasur dëgjime buxhetore? Për hir të transparencës, qytetarët e Prishtinës duhet ta dinë të vërtetën për këtë. Po ashtu, thuhet se ka pasur shkelje bazuare në nenin 61, paragrafi 2 të Ligjit për menaxhimin e financave.

**Endrit Zabërgja** tha se është tejet shqetësuese kur e shohim se një projekt kaq i madh, siç është buxheti një pikë kaq e madhe, po tentohet të politizohet, ku dhe përmes tij jepen edhe goditje politike, por nuk mund të kuptoj kur të njëjtat procedura në të kaluarën janë votuar nga të njëjtat njerëz, kurse sot tentojnë që në kuadër të të njëjtave veprime mundohen të na qesin neve asamblistëve tjerë si persona, apo përfaqësues që po mundohemi të bëjmë votim të jashtëligjshëm, përderisa diçka e tillë kanë ndodhur tash e 7 vjet. Nuk besoj që është mirë të manipulohet me qytetarin e Prishtinës, kur e njëjta procedurë, i njëjti buxhet nga partitë politike këtu sa kanë qenë në pushtet janë votuar.

**Leutrim Retkoceri**, kërkoi nga zyra e Kuvendit dhe Komuna, që të organizoj dëgjime me qytetarë ashtu siç e parashesh ligji, me të gjitha materialet që janë në këtë projektbuxhet, me të gjitha ato projekte për secilin kod buxhetor dhe kornizën afatmesme të shpenzimeve, të na dërgohen neve asambleistëve, pastaj të thirret një seancë e rregullt për votim të buxhetit të vitit 2025, dhe që i gjithë ky procesë të trajtohet me transparencë dhe me llogaridhënie para qytetarëve. Deri atëherë, ne si Grup i PDK-së nuk e shohim të rrugës të qëndrojmë në seancë, për shkak se kjo thirrje dhe ky hartim i këtij buxheti është me shkelje ligjore.

*Pas diskutimit të z. Retkoceri, GP i PDK-së e braktisën mbledhjen.*

**Arianit Beqiri** tha se ne e shohim vizionin e kësaj qeverisje që është koncentrua kryesisht në investime kapitale, sidomos nëpër rrugë, gjë që mund të ketë kuptim dhe është e drejtë dhe legjitime, por duhet kuptuar një gjë, që infrastruktura nuk është vetëm në rrugë, por ka edhe shumë gjëra të tjera në të cilat duhet të investohet, kryesisht në fushat të ndryshme edhe të drejtorive të tjera, ku ne kemi vërejtur se shumë projekte bazike nuk janë realizuar.

**Nora Kelmendi** tha se ky buxhet i propozuar fare nuk përkon me kërkesat e qytetarëve të Prishtinës, as me me programin e krytarit. Ky buxhet ka rënie të investimeve kapitale krahasuar me vitin 2024, për disa drejtori përkatëse. Lidhur me realizimin e këtij buxheti tha se, pasi që është viti i fundit i qeverisjes, nuk e di se si do të realizohen ato projekte aq të mëdha, pikërisht në konferencën që do ta realizoni pasnesër, pra në qoftëse janë projekte

të mëdha milionëshe, nuk besoj që mundeni me i realizuar brenda një viti, kështu që mendoj se në këtë buxhet të dorzuar nuk shihen se ka projekte të mëdha, si dhe nuk mund të realizoni as programin e juaj qeverisës. Më pas shtroi edhe disa pyetje, për të cilat kërkoi përgjigje nga ekzekutivi i Komunës, kryesisht përgjigje kërkoi nga kryetari i Komunës.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimete dhëna nga anëtarët e Kuvendit, sqarime të nevojshme dhanë Valbona Makolli, drejtore, Përparim Rama, kryetar dhe Izet Sadiku, drejtor.

Përparim Rama, kryetar, tha se, për shkak të numrit të madh të pyetjeve, ndoshta mënyra më e mirë është t'i marrim nga transkripti dhe më pas përgjigjet i kthejmë me e-mail.

Gëzim Sveçla tha se është e turpshme ajo çka deklaroi kryetari rreth kthimit të përgjigjeve. Më vjen turp, kryetar, duke të dëgjuar, po i vë në pozitë të keqe edhe një pjesë të asamblistëve edhe të drejtorëve që janë në pushtet. Po diskuton për 100, 200, 300 milionë dhe nuk je në gjendje një rrugë 100 metra me shtruar, prandaj është skandaloze kjo që po deklaroni. Prishtina po stagnon, buxheti nuk ka rritje, e vetmja rritje e buxhetit është prej grantit qeveritar dhe prej Ligjit të Kryeqytetit, e asnjë rritje tjetër nuk kemi. Ky është dështim, kryetar, ky është stagnim, kjo është pasqyra më e mirë çka po ndodh në Prishtinë, andaj ne nuk mund ta votojmë një buxhet të tillë.

*Kryesuesi tha se, në mungesë të kuorumit, mbledhjen e konsideroj të mbyllur.*

*Mbledhja përfundoi në orën 12:15.*

**Procesmbajtësi**  
**Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Fehmi Kupina**



**Faqe4nga4**